


## **DAC\_OTH\_01: Udhëzime të Leximit të Procedurave**

## Përmbajtja

1.	Hyrje.....	3
1.1.	Përmbledhje .....	3
1.2.	Prezantimi i përgjithshëm .....	3
2.	Procedurat .....	4
2.1.	Procedurat normale:.....	4
2.2.	Procedura Rezervë .....	5
2.3.	Procedura Alternative .....	5
2.4.	Procedurat e Veçanta.....	5
2.5.	Procedura të tjera .....	6
3.	Fjalor .....	6
	Shtojcë 1: Përkufizimet e Procedurave të DAC-it.....	7

## 1. Hyrje



### 1.1. Përmbledhje

Qëllimi i këtij dokumenti është të prezantojë parimet kryesore të përdorura në procedurat e DAC-it për një lexues të ri. Duhet të kuptohen disa koncepte bazë për të lexuar procedurat e DAC-it. Këto koncepte janë paraqitur këtu.

### 1.2. Prezantimi i përgjithshëm

Bashkimi i Tregut të Ditës në Avancë (DAC) është një proces që kalon në tre faza për të cilin janë krijuar një sërë procedurash që duhen zbatuar (përfshirë si Shtojcë "Marrëveshja Operacionale e Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë" - DACOA). Kryerja e çdo faze kërkon aplikimin e procedurave që përbëjnë grupin e procedurave të DAC-it në mënyrë që të sigurohet kryerja e veprimeve të nevojshme në mënyrë të koordinuar nga të gjitha palët e përfshira në Bashkimin e Tregut. Procedurat DAC ndahen në disa kategori që përshkruhen në këtë dokument:

- Procedurat normale (DAC\_NOR\_XX)
- Procedurat rezervë (DAC\_BUP\_XX)
- Procedurat alternative (DAC\_FAL\_XX)
- Procedurat e Veçanta (DAC\_SPE\_XX)
- Procedura të tjera (DAC\_OTH\_XX)


Skema e mëposhtme ofron një pasqyrë të marrëdhënies dhe periudhës kohore kur do të duhet të zbatohen këto procedura të ndryshme gjatë proceseve operacionale.

Tre koncepte duhet të mbahen parasysh gjatë leximit të procedurave:

- **Koha e Synuar** është afati i fundit i aplikuar në tregtimin real për realizimin e një procedure normale në baza ditore. Realizimi i një procedure normale duhet të kryhet para kësaj kohe/këtij afati.
- **Afati i fundit për të filluar një Komitet i Incidences** është afati i fundit për fillimin e procedurës alternative (fallback procedure), d.m.th. për përgatitjen e Ndarjes së Plotë.

- **Afati i Ndarjes së Plotë** është koha e përcaktuar si kritike për Bashkimin e Tregut, që do të thotë se pas kësaj kohe, Bashkimi i Tregut nuk mund të realizohet dhe zonat përkatëse të ofertimit dhe/ose ndërlidhësit janë të ndara (kapaciteti nuk alokohet tek Bashkimi i Tregut).

Këtu, duhet të theksohet se të gjitha **Oraret i referohen orës së Europës Qendrore (CET)**. Në figurën më poshtë, tre konceptet janë ilustruar në lidhje me kohën e procedurës normale, procedurës rezervë dhe procedurës alternative.



Duhet patur parasysh se Procedurat Normale mund të zbatohen ende edhe pas Kohës së Synuar, me kusht që të jetë ende e mundur të përdoret procedura Normale. Nëse përpara Kohës së Synuar bëhet e qartë se procedurat Normale nuk do të jenë të përdorshme në kohë, mund të vendoset të fillohet me procedurat rezervë (Backup) përpara Kohës së Synuar. I njëjti arsyetim vlen për afatin e fundit për ndërmarrjen e një IC-je. Per ta qartësuar, Ndarja (Ndarja e plotë) do të ndodhë vetëm pas Afatit të fundit të Ndarjes së Plotë.

## 2. Procedurat

Gjatë gjithë procedurave, duhet të merret parasysh niveli i DAC, pra procedurat që zbatohen për të gjitha palët e DAC. Kur i referohemi ndonjë procedure tjetër, kjo procedure duhet konsideruar si të gjitha procedurat e tjera që nuk janë në nivelin e DAC, p.sh procedurat dypalëshe ose çdo procedurë tjetër që nuk aplikohet tek DAC.

### 2.1. Procedurat normale:

Gjatë çdo faze, një sërë procedurash të zakonshme do të ndiqen në kushte normale.

Këto procedura quhen procedurat normale (DAC\_NOR\_XX) dhe ato përshkruajnë sipas fazave veprimet normale që duhet të kryhen nga palët DAC në skenarin më të mirë. Procedurat normale kryhen çdo ditë përpara Kohës së Synuar.

Ju lutemi vini re se aktivitetet që kanë lidhje me transaksionet nuk përfshihen në procedurat e DAC pasi ato trajtohen në nivel lokal.

- DAC\_NOR\_01: Dergimi i Kapaciteteve Ndërkufitare dhe i Kufizimeve të Alokimit
- DAC\_NOR\_02: Rezultatet Përfundimtare të MC
- DAC\_NOR\_03: Rezultatet e Bashkimit të Tregut dhe Transferimi i Shkëmbimeve të Skeduluara

- DAC\_NOR\_04: Konfirmimi i Tregtimit dhe Njoftimi i Shkëmbimeve të Skeduluara

## 2.2. Procedura Rezervë

Procedura Rezervë (DAC\_BUP\_XX) përshkruan veprimet mbështetëse që janë të disponueshme për të kapërcyer çdo problem (për shembull: dërgimi i një skedari në një mënyrë tjetër - me email). Në mënyrë ideale, procedura rezervë duhet të aktivizohet sapo Koha e Synuar e lidhur me një hap specifik të procesit nuk mund të përmbushet ose parashikohet të mos përmbushet nëpërmjet procedurave Normale.

Procedura Rezervë është e disponueshme në mënyrë që Bashkimi i Tregut të mund të përdoret ende për të gjitha hapat e tij (d.m.th., procedura alternative nuk aktivizohet).

Më poshtë mund të gjeni një përmbledhje të procedurave rezervë (*backup*) që duhet të zbatohen në rast se një incident ndodh në një nga tre fazat:

- DAC\_BUP\_01: Dërgimi i Kapaciteteve Ndërkufitare dhe Kufizimeve të Alokimit
- DAC\_BUP\_02: Rezultatet Përfundimtare të Bashkimit të Tregut

## 2.3. Procedura Alternative

Procedura Alternative (*Fallback*) (DAC\_FAL\_XX) aktivizohen kur rezultatet e Bashkimit të Tregut nuk mund të jepen në Afatin e Fundit për të Nisur një IC duke përdorur procedurat normale, rezervë ose të veçanta.

Procedurat Alternative (*Fallback*) mund të ndahen në dy pjesë:

- Përgatitja e Ndarjes së Plotë: Komiteti i Incidencës aktivizohet dhe ndërmerren veprime për të përgatitur ndarjen në rast se çështja nuk mund të zgjidhet përpara Afatit të Fundit për të filluar një IC.
- Ndarja e interkonektoreve përkatës nga Procesi i Bashkimit të Tregut:
  - Kapacitetet shpërndahen nëpërmjet ankandit eksplicit për interkonektorët e Ndare dhe vendosen në vlera 0 brenda procesit të bashkimit.
  - Librat e urdhërporosive janë rihapur dhe fillon një llogaritje e dytë e çmimit.

Brenda DAC, ekzistojnë disa procedura alternative (*fallback procedures*), të cilat zbatohen për të menaxhuar situata të paparashikuara. Në rast se çështja zgjidhet përpara Afatit të fundit të Ndarjes së Plotë, kryerja e procedurës alternative mund të ndërpritet, d.m.th. nuk kryhet Ndarja.

Procedurat e mëposhtme alternative janë krijuar në nivel DAC:

- DAC\_FAL\_01: Menaxhimi i Incidenteve
- DAC\_FAL\_02: Ndarja e Plotë

## 2.4. Procedurat e Veçanta

Procedurat e Veçanta (DAC\_SPE\_XX) kryhen kur ndodhin situata të jashtëzakonshme në treg që kërkojnë marrjen e masave specifike. Procedurat rezervë akoma mund të aplikohen gjatë Procedurave të Veçanta.

Procedurat e mëposhtme të Veçanta janë krijuar në nivel DAC:

- DAC\_SPE\_01: Ndikimi i Ankandëve të Dyta

## **2.5. Procedura të tjera**

Procedurat e tjera (DAC\_OTH\_XX) lidhen me disa situata specifike të planifikuara të cilat duhet të menaxhohen me një procedurë të formalizuar (ndërrimi i orës për shembull) dhe për çdo gjë tjetër që ka nevojë për një qasje të përbashkët në nivel DAC.

Procedurat “e tjera” që janë krijuar në nivel DAC janë si më poshtë:

- DAC\_OTH\_01: Udhëzime për Leximin e Procedurave
- DAC\_OTH\_02: Komunikimi i Brendshëm dhe i Jashtëm

## **3. Fjalor**

Një fjalor i bashkëngjitet kësaj procedure si Shtojcë.

## Shtojcë 1: Përkufizimet e Procedurave të DAC-it

Termi i Përdorur	Përkufizimi	Shkurtimi
<b>Kufizimet në Alokim</b>	Nënkupton kufizimet teknike të llogaritura dhe të ofruara nga OST-ja tek NEMO në mënyrë që të përdoren nga algoritmi PCR. Kufizimet e Alokimit mund të përfshijnë (por nuk do të kufizohen në): kufizimet e sigurisë operationale, kufizimet e shkallës së rritjes (ramping constraints), humbjet në transmetim.	AC
<b>Entiteti i alokimit</b>	Nënkupton OST ose një palë tjetër që ka të drejtë nga OST-ja për kryerjen e Ankandëve në Hije në rast se nevojitet Alokim Ekspllicit.	
<b>Alokimi/Alokimi i Kapacitetit</b>	Atribuimi i Kapaciteti Ndërkufitar. Alokimi e kapacitetit i referohet Alokimit Implicit (si për kapacitetin ashtu edhe për energjinë) nëse Zonat e Ofertimit janë në një treg të bashkuar. Alokimi i kapacitetit i referohet Alokimit Ekspllicit (vetëm për kapacitetin) nëse Zonat e Ofertimit janë në ndarje të plote të bashkimit të Tregut.	
<b>Zonë</b>	Zonë Ofertimi	
<b>Procedurë rezervë</b>	Procedurë e cila vihet në lëvizje jo më vonë se Koha e Synuar përkatëse nëse një çështje ndërpret procesin normal	BUP
<b>Zonë Ofertimi</b>	Hapësira më e madhe gjeografike brenda së cilës Anëtarët e Bursës janë të aftë të shkëmbejnë energji elektrike pa Alokim Kapaciteti.	BZ
<b>Kundërpalë Qendrore</b>	Nënkupton ALPEX-in që vendoset në mes të Palëve për Kontratat e dala nga Tregjet e ALPEX-it	PKK
<b>Ora Qendrore Evropiane</b>	Zona Kohore e Evropës Qendrore	CET
<b>Përbërësit</b>	I gjithë seti i informacioneve të ndryshme dhe sistemeve të teknologjisë së komunikimit (software dhe hardware), ndërfaqet me këto sisteme, të cilat janë të nevojshme për funksionimin e Bashkimit të Tregut.	
<b>Të Ardhurat nga Kongjestioni</b>	Të ardhurat e marra nga OST-të si rezultat i Alokimit të Kapacitetit në tregjet e Ditës në Avancë.	
<b>Entiteti i Shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni</b>	Nënkupton entitetin që luan rolin e shpërndarjes së të Ardhurave nga Kongjestioni.	CIDS
<b>Kapaciteti Ndërkufitar</b>	Aftësia e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike e interkonektuar për të akomoduar transferimin energjisë elektrike ndërmjet Zonave të Ofertimit. Ajo mund të shprehet si vlera e Kapaciteteve të Disponueshme Transferuese (ATC) ose parametrat e Mbështetur në Fluks dhe që merr parasysh Kufizimet e Alokimit. Për qëllim të Bashkimit të Ndërmjetëm, CZC-të kompozohen nga vlerat e Kapaciteteve Finale të Ofruara (FOC) dhe Kufizimeve të Alokimit.	
<b>Flukset Ndërkufitare</b>	Energjia e transferuar ndërmjet Zonave të Ofertimit që rezulton nga sesioni i Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë.	
<b>Kufizimi</b>	Situatë e tregut kur cmimet teknike minimale ose maksimale janë arritur në një Zonë Ofertimi dhe orë të veçantë. Në këtë situatë shumë urdhërporosi përputhen me çmimin e klerimit të tregut dhe për pasojë pëmbushen vetëm pjesërisht.	
<b>Komiteti i Përbashkët Drejtues i DAC</b>	Komiteti i Përbashkët Drejtues për Bashkimin në procedurat e DAC-it i referohet Komitetit të Përbashkët Drejtues në DAOA.	DAC JSC

<b>Nën-Komiteti Operacional i DAC</b>	Nen-Komitetit Drejtues Operacional i Bashkimit në procedurat e DAC-it i referohet OPSCOM-it në DAOA	DAC OPSCOM
<b>Raporti Ditor i Tregtimit</b>	Është një raport përmbledhës ditor që përfshin transaksionet ndërkufitare të bazuara në rezultatet e bashkimit të tregut (si, flukset orare ndërkufitare dhe diferencën e çmimit të tregut).	
<b>Bashkimi i Tregut te Ditës ne Avance</b>	Bashkimi i Tregut Implicit midis Zonave te Ofertimit te Shqipërisë dhe Kosovës	DAC
<b>Marrëveshja Operacionale e Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë</b>	Kontrata që rregullon operimet e Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë të DAC.	DAOA
<b>Tregu i Ditës në Avancë</b>	Afatet e tregut kur transaksionet tregtare ekzekutohen në ditën para ditës së livrimit të produkteve të tregtuara.	DAM
<b>Pranimi i Supozuar</b>	Një situatë ku Rezultatet Përfundimtar MC është konsideruar pozitiv për shkak të mungesës së një përgjigje (pozitive ose negative) nga palët validuese brenda një periudhe kohe të caktuar.	
<b>Koha e Përfundimit</b>	Koha/Ora kur duhet të përfundohet një hap.	
<b>Anëtar i Bursës</b>	Entiteti i autorizuar nga Bursa për te vendosur urdhërporosi	
<b>Alokimi EksPLICIT (Kapacitetit)</b>	Alokimi vetëm i Kapacitetit Ndërkufitar, pa alokimin në të njëjtën kohë të energjisë dhe kur pala tjetër është e njohur.	
<b>Ankandi EksPLICIT</b>	Ankande të kapaciteteve pavarësisht nga transaksionet e tregtimit të energjisë.	
<b>Komunikim i Jashtëm</b>	Fluks komunikimi nga NEMO drejt OST-eve dhe Anëtarëve të Bursës dhe palëve të tjera të interesit.	ExC
<b>Procedurë Alternative</b>	Procedura që vihet në zbatim nëse procedurat rezervë nuk arrijnë të zgjidhin një çështje, që mund të çojë në një situatë të Ndarjes së Plotë të tregut të bashkuar	FAL
<b>Rezultatet Përfundimtare te Bashkimit te Tregut</b>	Konfirmimi nga OST-të e Rezultateve të Bashkimit të Tregut (mbas konfirmimit rezultateve Paraprake Global nga NEMO), lidhur vetëm me CZC-të dhe Kufizimet opsionale të Alokimit.	Rezultatet Përfundimtare MC
<b>Kapaciteti Përfundimtar i Ofruar</b>	Vlera e Kapacitetit të Transmetimit që i ofrohet tregut dhe që përdoret në llogaritjen e Bashkimit të Tregut. Kapaciteti Përfundimtar i Ofruar është i barabartë me kapacitetet e disponueshme të transmetimit. Ai rrjedh nga Kapacitetet e Ofruara që jepen nga OST-të përkatëse. Së bashku me Kufizimet e Alokimit ai është pjesë integrale e CZC-së.	FOC
<b>Ndarja e plotë e Bashkimit të Tregut-Rasti 1</b>	Rezultate e Ankandit të Ditës në Avancë nuk mund të përcaktohen në kohën e paparë ose Rezultatet paraprake të tregut nuk janë konfirmuar nga ALPEX dhe/ose OST	FD1
<b>Ndarja e plotë e Bashkimit të Tregut-Rasti 2</b>	Paraqitja me vonesë e sesionit të Kapacitetet ndërkufitare.	FD2
<b>Ndarja e plotë e Bashkimit të Tregut-Rasti 3</b>	Ndarja e Plotë e Njohur Paraprakisht	FD3
<b>Afati i fundit i Ndarjes së Plotë të Tregut</b>	Momenti i fundit në kohë kur një Ndarje e Plotë mund të deklarohet nga Komiteti i Incidenteve.	
<b>Koha e Mbylljes së Portës/ Koha e Mbylljes së Portës së librit të urdhërporosive</b>	Koha e identifikuar për mbylljen së librit të urdhërporosive të NEMO-s. Ky është momenti i fundit për një pjesëmarrës që të vendosë një urdhërporosi në platformën e tregtimit.	GCT/ NEMO GCT



<b>Rezultatet Përfundimtare Globale</b>	Rezultatet e Bashkimit të Tregut që janë konfirmuar nga NEMO dhe OST-të (OST-të ne respekt vetëm te CZC dhe Kufizimeve opcionale te Alokimit gjate raundit te pare te konfirmimeve) Fajli i Rezultatet Përfundimtare Global nxirret nga Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit dhe konfirmon Rezultatet e Bashkimit të Tregut	
<b>Arkitektura Funktionale e Nivelit të Lartë</b>	Dokumenti që jep skemën e përgjithshme të flukseve të DAC-it.	HLFA
<b>Komitetit i Incidencës</b>	Komiteti vendimmarrës që iniciohet nga NEMO sapo të arrihet Afati i Fundit për të filluar një Komitet të Incidenteve.	IC
<b>Raporti i Komitetit të Incidencës</b>	Raporti i plotësuar dhe i siguruar nga NEMO mbas një Sesioni të Bashkimit të Tregut kur një incident kërkon iniciimin e Komitetit të Incidencës.	
<b>Interkonektor</b>	Linjë transmetimi e cila pret ose kalon një kufi ndërmjet vendeve, dhe që lidh sistemet kombëtare të transmetimit të vendeve.	
<b>Komunikim i Brendshëm</b>	Fluksi i komunikimit me e-mail ndërmjet NEMO-ve dhe OST-ëve të DAC-it.	InC
<b>E njohur në Avancë</b>	Situata kur çështja kritike që çon në Ndarjen e Plotë të Bashkimit të Tregut është identifikuar tashmë sepse çështja mund të kishte shkaktuar Ndarjen e Plotë të Bashkimit të Tregut për Sesionin e mëparshëm të Bashkimit të Tregut.	
<b>Afati i Fundit për të Filluar një Komitet të Incidencës</b>	Momenti i fundit në kohë kur një Komitet Incidentesh duhet të organizohet nga Koordinatorin i PMB-së.	
<b>Fluksi në Orën e Fundit</b>	Kapaciteti i tregtuar i Orës së Fundit të ditës paraardhëse, i nevojshëm për shkak të çdo kufizimit të luhatjes dhe për optimizimin e llogaritjes së volumeve të bashkimit.	LHF
<b>Rezultatet e Tregut Lokal</b>	Rezultatet e publikuara nga NEMO-t mbas ankandëve lokale.	
<b>Bashkimi i Tregut</b>	Procesi i ankandit implicit për të alokuar kapacitetet e transmetimit në një rajon të caktuar.	MC
<b>Rezultatet e Bashkimit të Tregut</b>	Rezultatet e përlllogaritura nga Algoritmi PCR (EUPHEMIA), që përmban flukset, Pozicionet Neto, çmimet.	MC Results
<b>Sesion i Bashkimit të Tregut</b>	Ankandi ditor në Tregun e Ditës në Avancë që bëhet një ditë më përpara se dita e livrimit.	MCS
<b>Operator i Tregut</b>	Operatori përgjegjës lidhur me kufijtë e vendit përkatës, për dërgimin e Rezultatit të Bashkimit të Tregut tek OST-të me qëllim kontrollin dhe aprovimin dhe për çuarjen drejt PCR sipas procedurës lokale. Këtë rol e kryen NEMO	
<b>Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit të Bashkimit të Tregut</b>	Sistemi TI i Operatorit të Bashkimit të Tregut përgjegjës për llogaritjen e e Rezultatit të Bashkimit të Tregut, duke kryer funksionet e DA MCO gjatë Bashkimit të Tregut sipas procedurës NEMO-MCO	MCO
<b>NEMO</b>	Do të thotë Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike i caktuar sipas Rregullave të NEMO-s së Shqipërisë dhe/ose Kosovës.	NEMO
<b>Sistemi i Klerimit dhe Shlyerjes së NEMO-s</b>	Nënkupton pjesë të Sistemit Lokal të Tregtimit të NEMO e dedikuar për aktivitetet e Agjentit të Transfertes ( që kontrollon Skedulin e Shkëmbimeve krahasuar me Pozicionin Neto, duke dërguar konfirmimet e tregtimit lidhur me detyrime e CCP dhe dërgimin e rezultateve te CID )	

<b>Operatori i NEMO-s</b>	Person i cili operon Sistemin e Tregtimit te NEMO	
<b>Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s</b>	Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s nënkupton: 1. Infrastrukturën TI e cila mund të përfshijë komponentët si vijon: Modulin e Para- Bashkimit të Tregut, Modulin e Verifikimit të Bashkimit të Tregut, Modulin pas Bashkimit të Tregut. 2. Sistemin Elektronik i mbajtur dhe i operuar në mënyrë të pavarur nga NEMO për të bërë të mundur ankandet ditore ne Tregun e Ditës në Avancë. 3. Sistemi i dedikuar për marrjen dhe grupimin e Kapaciteteve Ndërkufitare dhe Kufizimet ne Alokim nga OST-të dhe dërgimin e këtij skedar tek Sistemi i TI të Ofruesit të Shërbimit. 4. Sistemi që kontrollon dhe pranon rezultatet e PCR deh Pozicionit Neto për Zone Ofertimi kundrejt CZC dhe AC dhe i dërgon ato tek OST-të.	
<b>Pozicioni Neto</b>	Shuma neto e eksporteve dhe importeve për çdo Njësi Kohe të Tregut për një Zone Ofertimi të dhënë.	NP
<b>Të Dhënat e Rrjetit</b>	Skedari i CZC-eve të grupuara dhe Kufizimeve të Alokimit dërgohet nga Moduli i Para-Bashkimit të Tregut të NEMO-s tek Sistemi i TI të Ofruesit të Shërbimit.	
<b>Procedura normale</b>	Procedura që përshkruan proceset normale dhe afatet kohore normale të Sesionit të Bashkimit të Tregut.	NOR
<b>Afati i fundit i njoftimit</b>	Momenti i fundit në kohë kur është e mundur dërgimi i njoftimit ditor.	
<b>Procesi i njoftimit</b>	Procesi gjatë të cilit njoftimet u dërgohen OST-ve.	
<b>Urdhërporosi</b>	Do të thotë një ofertë e një e Anëtari të Bursës për të shitur ose i një kërkesë për të blerë energji elektrike brenda Zonës Ofertimit të Shqipërisë ose Kosovës, në lidhje me një Portofol specifik, MTU, volumi dhe çmimi në përputhje me specifikimet për produktin në fjalë.	
<b>Procedura të Tjera</b>	Procedura që trajtojnë kryesisht aspektet organizative dhe te komunikimit.	OTH
<b>Pas-Bashkimit</b>	Procese që vijnë pas llogaritjes dhe kontrollit dhe pranimit të Rezultateve të Bashkimit të Tregut, kryesisht lidhur me Shkëmbimet e Planifikuara/Programuara dhe të Ardhurat nga Kongestionet.	
<b>Para- Bashkimit</b>	Procese para llogaritjes së Rezultateve të Bashkimit të Tregut lidhur me CZC-të dhe Kufizimet e Alokimit.	
<b>Konfirmimi Paraprak Global</b>	Skedari i Konfirmimit Global nxirret nga Sistemi TI i Ofruesi i Shërbimit MC dhe konfirmon nëse Rezultatet i Bashkimit te Tregut janë ose jo te kontrolluar dhe pranuar vetëm nga NEMO	
<b>Rezultatet Paraprake të Bashkimit të Tregut</b>	Rezultatet te Bashkimit të Tregut të cila janë te konfirmuara vetëm nga NEMO ( raundi i parë i kontrollit dhe pranimit) dhe që mund të shpallen kundrejt OST-ve dhe Anëtarëve të Bursës.	
<b>Zona e Bashkimit të Çmimeve</b>	Të gjitha hapësirat që bashkohen nga një mekanizëm i Bashkimit të Tregut	
<b>Bashkimi i Çmimit të Rajoneve</b>	Zgjidhje e Bashkimit të Tregut të Vetëm që përdoret për llogaritjen e çmimet e energjisë elektrike dhe alokimin e kapacitetit ndërkufitar mbi baza të ditës në avancë.	

<b>Brokëri i Përputhjes së Çmimit</b>	Një Software që mundëson shkëmbimin e të dhënave ndërmjet NEMO-ve, duke futur algoritmin PCR, që përdoret për të operuar Bashkimin e Rajoneve dhe për të siguruar Rezultatet e Bashkimit të Tregut.	PMB
<b>Kufizimet e rampimit</b>	Një term i përdorur për ndryshimin maksimal të fluksit të energjisë elektrike në një Inetrkonektor ndërmjet dy orëv të njëpasnjëshme.	
<b>Koha e Publikimit / Koha e Rregullt e Publikimit</b>	Koha e përfshirë në skedarin e Konfirmimit Paraprak Global dhe që përfaqëson kohën më të afërt kur mund të publikohen Rezultatet Paraprake të Bashkimit të Tregut. Në situata normale, Koha e Rregullt e Publikimit është 13:00.	
<b>Rregullat e Rendit të Brendshëm</b>	Udhëzimet që drejtojnë takimet dhe mënyrën e të punuarit të komitetit përkatës, procedurat e rekomanduara për të siguruar që vendimmarrjet janë bërë në një mënyrë të rregullt.	RIO
<b>Shkëmbimet e Skeduluara</b>	Transferimi i planifikuar ndërmjet Zonave Ofertuese për çdo Njësi Kohe të Tregut dhe për një drejtim të dhënë.	
<b>Njoftimi i Shkëmbimeve të Skeduluara</b>	Një mesazh që dërgohet nga Sistemet CCP tek Sistemet e Brendshme (Back-End Systems) të OST-ve për ti njoftuar OST-të që Shkëmbimet e Planifikuara janë procesuar.	
<b>Ankandi i Dytë</b>	Rihapja e librit të urdhërporosive të NEMO-s që iniciohet kur rezultatet e llogaritjes së parë përfshijnë çmime që janë mbi ose nën Kufijtë e Lejuar të paracaktuara për një ose disa orë. Gjatë rihapjes, Anëtarët e Bursës lejohen që të ndryshojnë urdhërporositë e tyre.	
<b>SEE CAO</b>	Do të Thotë Zyra e Ankandave të Koordinuara në Europën Jug-Lindore	
<b>Ankand Hije</b>	Sistemi që mundëson organizimin e ankandave eksplicite për Alokimin e Kapacitetit të Ditës në Avancë pas Ndarjes së Plotë në përputhje me procedurat alternative.	SA
<b>Agjent i Transaksioneve</b>	Entitet që kryen funksionet e transferimit të Pozicioneve Neto ndërmjet Kundërpalës Qendrore.	
<b>Procedurë e veçantë</b>	Procedura që merren me procese specifike që ndodhin vetëm në situata të veçanta.	SPE
<b>Koha e Synuar</b>	Momenti i fundit në kohë kur një procedurë rezervë duhet të iniciojë.	
<b>Kufijtë e Lejuar</b>	Limitet e paracaktuara të çmimit kur iniciohet një Ankand i Dytë.	
<b>Operatori i Sistemit të Transmetimit</b>	Do të thotë një entitet përgjegjës për operimin, sigurimin, mirmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit dhe përfshin mbajtësin e një licence për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të lëshuar nga një Autoritet Rregullator përkatës.	TSO
<b>Sistemi TI i OST-së</b>	Sistemi TI i OST-së nënkupton: 1. Sistemin TI të OST-të i dedikuar për të prodhuar të dhëna lidhur me llogaritjen e kapacitetit. 2. Sistemin TI të OST-të i dedikuar për llogaritjen e Shkëmbimet e Skeduluara. 3. Sistemin TI të OST për llogaritjen e Kapacitetit Ndërkufitar nën modelin e rrjetit dhe një metodologjie të koordinuar të llogaritjes së kapacitetit.	

<b>Dokumenti i Rezultateve</b>	Set të dhënash në një format të rënë dakort më parë që sigurohet nga NEMO si rezultat i llogaritjes së MC që përmban informacion të saktë mbi pozicionet neto të rrumbullakosura/përafërta, çmimin e rrumbullakosur/përafërt të klerimit të tregut dhe flukset ndër-kufitare për të gjithë hapësirën e bashkuar.	RD
<b>Skedari Zero</b>	Skedari CZC, i cili përmban vlerat zero që duhen në rastin e një Ndarje/Ndarj në nivel Interkonektori.	